


NJË LAJM FANTASTIK PËR TRASHËGIMINË KULTURORE!

Manastiret e Luginës së Drinos janë në [#WorldMonumentsWatch](#) 2025 përmes një nominimi të Vandrille Potez.

Përfshirja e këtyre siteve në Watch List synon të rrisë ndërgjegjësimin për ruajtjen dhe promovimin e tyre, duke nxjerrë në pah dhe mundësi për mbështetje financiare.

Që prej vitit të kaluar, CHwB Albania është duke zbatuar projektin “Rrugët kulturore të Manastireve të Luginës së Drinos: Lidhja e Komuniteteve Rurale”, mbështetur nga [#AFCP](#) - Fondi i Ambasadorit për Trashëgiminë Kulturore [U.S. Embassy Tirana](#). Ky projekt përfshin masa konservuese për dy manastire dhe krijimin e dy shtigjeve që lidhin manastiret në të dy anët e luginës. Kjo nismë përfaqëson një moment të rëndësishëm që ka për qëllim ruajtjen dhe promovimin e zonës, si dhe rritjen e ndërgjegjësimit për potencialin që Lugina e Drinos dhe trashëgimia e saj kulturore paraqet.



KISHA E SHËN SERGJIT DHE BAKUT - HIMARË

Specialistët e IKTK vizituan **Kishën e Shën Sergjit dhe Bakut në Himarë**, në kuadër të projektit të restaurimit të këtij monumeti të rëndësishëm të trashëgimisë kulturore. Kisha, e pozicionuar brenda mureve të Kalasë së Himarës, në kuotën më të lartë të saj, daton në fundin e shek. X dhe fillimin e shek. XI.

Muret e saj dëshmojnë disa faza ndërtimore, ndërsa pikturat murale pasbizantine ruhen ende në ambientin e bemës. Dikur seli e Peshkopatës së Himarës, kjo kishë pasqyron historinë dhe artin e periudhës së saj. Restaurimi do të sigurojë ruajtjen e vlerave të pa diskutueshme të kësaj pasurie kulturore dhe tejçimin e tyre brezave të ardhshëm.



KISHA E SHËN MËRISË - BISHQETHËM

Fillojnë ndërhyrjet konservuese/restauruese në **Kishën e Shën Mërisë, në fshatin Bishqethëm.**

Kisha është një objekt kulti tipik i ndërtimeve të shek. XVIII.

Pikturat janë realizuar nga Johani i cili i përket familjes së Çetirëve nga Grabova, në vitin 1798. Disa prej tyre ruhen në gjendje të mirë dhe përbëjnë një faktor të rëndësishëm kulturor për t'u vizituar.

Ndërhyrjet konsistojnë në :

- Restaurimi i çatisë me tjegulla të reja dhe zëvendësim i trarëve të amortizuar;
- Restaurimi i muraturave me teknikën Shqep-Qep, me injektim, fugatim dhe suvatim;
- Konsolidimi i materialeve të drurit;
- Konsolidimi i muraturave dhe brezave të drurit;
- Pastrime të fasadës dhe pastrime të objektit në brendësi dhe sipërfaqen rreth tij.



KALAJA E LEZHËS



Një tjetër thesar i historisë dhe trashëgimisë sonë kulturore, **Kalaja e Lezhës**, ka përfituar nga paketa e rindërtimit pas tërmetit përmes programit **EU4Culture** të financuar nga BE, në bashkëpunim me **UNOPS Albania**.

Projekti i quajtur **“Stabilizim emergjent i murit verior të Kalasë së Lezhës”** mundësoi:

- Sigurimin dhe mbrojtjen e strukturave historike.
- Konservimin arkitektonik të monumentit.
- Rikthimin e territorit në gjendjen e tij origjinale.

Muret perimetrale të kalasë kanë rilindur me një pamje të përmirësuar dhe të qëndrueshme, duke nxjerrë në pah çdo vlerë dhe fazë historike të këtij monumenti unik.

Kalaja e Lezhës, tashmë jo vetëm një simbol historie, por edhe një shembull i përkushtimit për ruajtjen e trashëgimisë kulturore!



KISHA E SHËN DËLLISË - BUHAL, PËRMET

DRTK Gjirokastër dhe Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore, në bashkëpunim me **CHwB Albania** si dhe mbështetjen e **#GertaHenkelStiftung**, kanë nisur ndërhyrjen emergjente në Kishën e Shën Dëllisë (Profet Ilisë) në fshatin Buhal të Përmetit. (Monument Kulture Kategori e I-rë).

Ndërhyrje që do të kryhen:

- Restaurim çatie;
- Punime restaurimi në muraturë;
- Vendosje tirantash, për të garantuar rruajtjen dhe mbrojtjen e këtij objekti të rëndësishëm kulturor.



ZBULIME ARKEOLOGJIKE

Një udhëtim në të shkuarën përmes gjetjeve arkeologjike! Zbulimet e bëra ndër vite na tregojnë për jetën, kulturën dhe historinë e pasur të tokës sonë. Çdo artefakt mbart një histori të veçantë, duke ndriçuar të shkuarën dhe duke forcuar lidhjen tonë me të.

